



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Malishevë



Drejtoria e Shërbimeve Publike

Nr. 09/512.

Datë:14.11.2023 .

Nga: Rifat Mazreku, Drejtor i DSHP-së _____

Për : z/Ekrem Kastrati , Kryetar i Komunës së Malishevës

Lënda : Plani vjetor i punës për vitin 2024

Nëntor , 2023

Hyrje

Qëllimi i planit të punës është evidentimi i prioriteteve të drejtorisë për vitin 2024, objektivat e synuara për realizim gjatë këtij viti duke u bazuar në Planin zhvillimor Komunal 2017-2025 , aktivitetet e nevojshme për realizimin e objektivave të përcaktuara, dhe bashkëpunimi me institucionet tjera relevante të cilat do të ndihmojnë realizimin e këtij plani të punës. Plani synon të rrit nivelin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore sipas fushës që mbulon drejtoria e shërbimeve publike dhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve.

Në vazhdim po i paraqesim prioritetet dhe objektivat e synuara për vitin 2024;

FUSHA : MENAGJIMI I MBETURINAVE

- ✚ Hartimin e PKMM-së (Planit komunal për menagjimin e mbeturinave).
- ✚ Formimi dhe funksionalizimi i sektorit për Menagjimit të Mbeturinave.
- ✚ Vazhdimi i pilot projektit për Edukim Mjedisor, grupi i synuar klasët e 6 (gjashta) të shkollave.
- ✚ Hulumtimi i Riciklimit, lidhja e marrëveshjeve me kompanitë përkatëse për grumbullimin e plastikës (kapakëve të shisheve) dhe kanaqeve në shkollat e synuara.
- ✚ Hulumtimi, Identifikimi , largimin dhe rrafshimin e deponive ilegale inerte .
- ✚ Mbledhja dhe raportimi i shënimeve.
- ✚ Mbikëqyrja e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për mbledhjen e mbeturinave.

FUSHA : TRANSPORTI URBAN

- ✚ Përmirësimi i sigorisë në trafik, përkujdesja për sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve ekzistuese dhe mirëmbajtja e tij ,marrja e masave për sinjalizimin vertikale dhe horizontale të ri në vendbanime ;
- ✚ Përmirësimi i rrjetit të transportit , mbulueshmëria e të gjitha vendbanimeve me transport adekuat dhe të rregullt publik;

- + Caktimi i linjave urbane dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve;
- + Plani i Transportit i Komunës së Malishevës 2024-2029;

FUSHA TE TJERA

- + Mbikqyrja e ofrimit të shërbimeve publike lokale, furnizimin me ujë, rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- + Mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale në vendbanime, pastrimin e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit ;
- + Organizimi në mirëmbajtje dhe zhbllokimin eventual të rrjetit të ujrave atmosferike dhe atyre të zeza;
- + Mirëmbajtjen dhe rregullimin e hapësirave publike, hapësirave gjelbëruese, parqeve publike dhe varrezave të Dëshmorëve dhe lapidareve;
- + Vazhdimi dhe mbikqyrja e realizimit të shërbimeve që ofrohen për heqjen e shpenzimeve të varrimit të qytetarëve të KK-Malishevës në rast vdekjeve.
- + Përkujdesja dhe marrja e masave adekuate në raste të festave lokale, shtetërore dhe Kombëtare (furnizimi ,vendosja dhe largimi i flamujve në qytet) , lapidare dhe varreza të dëshmorëve:
- + Bashkëpunimi me policinë për ngritjen e sigurisë në komunikacion (qytetarëve dhe automjeteve), në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
- + Bashkëpunimi me kompaninë që ofron shërbime rreth kyçjeve në sistemin e ujësjellësit, ndërhyrjeve teknike dhe mbikëqyrjen e orarit të reduktimeve;
- + Pëlqimet – lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike sipse legjislacionit në fuqi .
- + Mbikëqyrja e realizimeve të punimeve për rregullimin e gjelbërimit dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme për hapsira të gjelbërta;
- + Dhënja e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve afariste e hoteliere;

- ✚ Dhënja e lejeve për tabelat reklamuese, reklamat ndriçuese të firmave dhe reklamave të ndryshme;
- ✚ Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik komunal.
- ✚ Përkujdesja për menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e të gjitha parqeve shesheve dhe varrezave të Dëshmorëve në territorin që i përket komunës;
- ✚ Bashkëpunimi me Drejtorinë përgjegjëse për eliminimin e defekteve në rrugë në territorin që i përket Komunës;
- ✚ Mbikëqyra dhe bashkëpunimi në ndertimin e shtëpiave me OJQ-në QATAR CHARITY me seli në Kosovë ;
- ✚ Bashkëpunimi me OJQ-në QATAR CHARITY me seli në Kosovë për hapjen e puseve të ujit të pishëm për familjet në kushte të renda ekonomike dhe sociale.
- ✚ Bashkëpunimi me FKEE-në (Fondi i Kosovës për Efiçencën e Energjisë) për planifikimin dhe realizimin e masave efiçente të energjisë në objektet publike të Komunës (OBS-01);
- ✚ Marrja e masave të duhura për ruajtjen e ujërave sipërfaqësore dhe të atyre nëntokësore nga ndotësit eventual;
- ✚ Eliminimi i defekteve dhe dëmeve eventuale në hapsirat publike që shkaktohen gjatë ndërtimeve apo punimeve të ndryshme në bashkëpunim me drejtorinë e urbanizmit dhe drejtorin e inspektoriatit ;
- ✚ Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të Drejtorisë.

Shënim: Përmes këtij plani të punës synojmë realizimin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara si udhëheqje e qeverisjes lokale për vitin 2024.

Me respekt